

Nr. 336 Prot
Date 24.02.2026

Procesverbal i mbledhjes se Keshillit Bashkiak date 19.02.2026

Ora 17:00

Salla e mbledhjeve te Keshillit Bashkiak, Njesia Administrative Xhafzotaj, Kati 3

Mungojne:

1. Erga Shkodra
2. Mentor Kllari
3. Kadri Metaliu
4. Arlind Bici
5. Serme Elezi
6. Mentor Jamaku
7. Myrteza Ramilli

Sulejman Tola (Kryetar i Keshillit Bashkiak): Pershendetje te gjithëve! Meqenese e kemi kuorumin e nevojshem mbledhjen e deklaroj te hapur.

Sulejman Tola (Kryetare I Keshillit Bashkiak): Kjo mbledhje ka rend dite:

1. "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i veçantë, për periudhën 1–28 shkurt 2026".
2. "Për miratimin e rregullores për matjen dhe raportimin e performances në Bashkinë Shijak".
3. "Mbi monitorimin e buxhetit të Bashkisë Shijak për periudhën janar–dhjetor 2025. (Informim – pa votim)".
4. "Për ndryshimin e VKB nr. 28, datë 26.08.2024, mbi miratimin e pagave të punonjësve dhe personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në Bashkinë Shijak për vitin 2026".
5. "Shtesë buxheti për vitin 2026, për pjesën e të ardhurave të trashëguara nga viti 2025".
6. " Informim mbi procedurën e ndërmarrë për hapjen e klasave në gjuhën boshnjake në shkollën 9-vjeçare "Adem Sabli", Borakë, Bashkia Shijak. (Pa votim)".

E hedhim ne votim rendin e dites.

Kozeta Doda (Sekretare e Keshillit Bashkiak):Hapim procesin e votimit per rendin e dites.

Pro:14

Kunder:-

Abstenim:-

Miratohet

Sulejman Tola:Vazhdojme me piken e pare te rendit te dites.

Fjalen ja japim Drejtoreshës ekonomike Znj.Pranvera Alushi të na relatojë materialin e ndihmës ekonomike.

Pranvera Alushi:Pershendetje !

Propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga të ardhurat e bashkisë me një fond prej 166.600 lekësh , 62 familje, detajuar si më poshtë:

- 33 familje në qytetin e Shijakut, me një fond prej 95.900 leke sipas table 1.
- 21 familje në Njësinë Administrative Xhafzotaj , me një fond prej 55.700 lekë,
- sipas tabelës nr.2
- 7 familje në Njësinë Administrative Maminas, me një fond prej 18.500 lekë, sipas tabelës nr.3
- 1 familje në Njësinë Administrative Gjepale , me një fond prej 2500 lekë, sipas tabelës nr.4

Faleminderit!

Sulejman Tola :Kush ka pyetje ?

Sulejman Tola:E hedhim ne votim .

Kozeta Doda (Sekretare e Keshillit Bashkiak):Hapim procesin e votimit per piken e pare te rendit te dites.


Pro:14

Kunder:-

Abstenim:-

Miratohet

Sulejman Tola (Kryetar i Keshillit Bashkiak):Vazhdojme me piken e dyte.Fjalen e mer Znj.Sonila Guzina.



Sonila Guzina: Të nderuar këshilltarë,

Referuar Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe kuadrit nënligjor në fuqi për planifikimin strategjik dhe menaxhimin e performancës në njësitë e vetëqeverisjes vendore,

Në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, llogaridhënies dhe eficiencës në përdorimin e burimeve publike, matja dhe raportimi i performancës përbën një instrument thelbësor për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike dhe rritjen e besimit të qytetarëve ndaj administratës vendore.

Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" parashikon detyrimin e bashkive për planifikimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave publike vendore, si dhe raportimin periodik për realizimin e objektivave strategjike dhe buxhetore. Në këtë kuadër, është e domosdoshme miratimi i një rregulloreje të posaçme, e cila përcakton qartë mekanizmat, procedurat, përgjegjësitë institucionale dhe indikatorët për matjen dhe raportimin e performancës në Bashkinë Shijak.

Rregullorja për Matjen dhe Raportimin e Performancës në Bashkinë Shijak synon të krijojë një sistem të qëndrueshëm dhe të unifikuar për vlerësimin e performancës së strukturave administrative, programeve buxhetore dhe shërbimeve publike, duke siguruar lidhjen ndërmjet planifikimit strategjik, buxhetimit dhe rezultateve konkrete të arritura.

Ky instrument rregullator do të shërbejë gjithashtu për:

- forcimin e kulturës së performancës brenda administratës bashkiake;
- rritjen e eficiencës dhe efektivitetit në përdorimin e fondeve publike;
- përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve;
- garantimin e transparencës dhe llogaridhënies institucionale;
- mbështetjen e procesit të vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak mbi baza të matshme dhe të verifikueshme.

Në mbështetje të nenit 54 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, i cili i njeh Këshillit Bashkiak kompetencën për miratimin e rregulloreve që lidhen me organizimin dhe funksionimin e administratës bashkiake, si dhe në funksion të standardizimit të procesit të matjes dhe raportimit të performancës institucionale,

Ju paraqesim për miratim Rregulloren për Matjen dhe Raportimin e Performancës për Bashkinë Shijak, si një akt i domosdoshëm për përmirësimin e menaxhimit administrativ dhe financiar të bashkisë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, shprehim bindjen se miratimi i kësaj rregulloreje do të kontribuojë ndjeshëm në rritjen e eficiencës, transparencës dhe cilësisë së qeverisjes vendore në Bashkinë Shijak

Sulejman Tola :Kush ka pyetje ?



Kozeta Doda (Sekretare e Keshillit Bashkiak):Hapim procesin e votimit per piken e dyte te rendit te dites.

Pro:14

Kunder:-

Abstenim:-

Miratohet

Sulejman Tola:Vazhdojme me piken e tretë të rendit te dites.

Fjalën ja japim Drejtoreshës ekonomike Znj.Pranvera Alushi.Ky material është vetëm informacion pa votim.

Pranvera Alushi: Të ardhurat Lokale për Bashkinë Shijak për periudhën Janar – Dhjetor 2025 janë realizuar në masën 79 % ndaj planit 12 mujor dhe me një diferencë në minus në vlerën 74,287 mijë lekë.

Krahasuar me të njëjten periudhë të vitit të kaluar në total të ardhurat janë realizuar me shumë 33% se vitin e kaluar ,dhe në vlerë ato janë 70,661 mijë leke më shumë se 12 mujori 2024.

Më poshtë po bëjmë analizen e të ardhurave që zënë peshën specifike më të madhe në të ardhurat e Bashkisë:

Taksa mbi Ndërtesën : Planifikimi i taksës së ndërtesës për periudhën Janar – Dhjetor 2025 në total ka qënë 57,330 mijë lekë, dhe në fakt është realizuar 45.994 mijë lekë , ose 80 %. Kjo taksë realizohet nga dy kategori ,Biznes dhe Popullsia.

Sa shihet pjesa më e madhe e realizimit të taksës së ndërtesës vjen nga kategoria biznesit e cila për periudhën 12 mujore është realizuar vetëm 83 %.

Ndërsa popullsia ka realizuar diferencën e kësaj të ardhure ,dhe akoma për faktin se nuk kemi arritur të bëjmë një marrëveshje me Ndermarrjen Ujesjelles Kanalizime Durres për faturimin e kësaj takse në faturat e Ujit të pijshëm. Vijon puna nga Drejtoria e taksave Tarifave dhe Kadastres fiskale për arketimin e të ardhurave nga subjektet dhe popullsia.

Realizimi i të ardhurave nga taksa e Infrastrukturës dhe kontrolli i territorit shkon në masën 83 %.

Sic shihet kjo taksë është realizuar në masën 83 % dhe në vlerë -14,330 mijë leke , Ky mosrealizim ka ndikuar në totalin e të ardhurave në masën 19 %. Kjo për shkak të mos dhënies së lejeve të ndërtimit me pagesë për arsye të ndryshme si mungesa e dokumentacionit nga aplikuesit për leje ndërtimi etj.Taksa e ndikimit në infrastrukturë mbledhet nga Drejtoria e Urbanistikës në momentin e aplikimit për leje.

Të ardhurat e taksës së truallit per periudhen 12 mujore eshte realizuar në ma Planifikimi dhe realizimi i te ardhurave nga taksa e truallit eshte ne masen 98 % ,ose me nje realizim ne vlere per 8,218 mije leke,dhe ne krahasim me vitet paraardhes kemi nje rritje ne vlere 2,751 mije leke.

Taksa e tabelës : Të ardhurat nga kjo taksë paraqiten si më poshtë:

Realizimi i të ardhurave nga taksa e tabelës dhe reklames per periudhen 8 mujore eshte e realizuar në masën 66 %.Kjo Takse paguget nga subjektet sipas tabelave dhe reklamave te vendosura ne ambjentet ku ushtrojne aktivitetin.

Tarifa e Shërbimeve Pastrimit.

Planifikimi i tarifës së shërbimit te pastrimit për periudhen Janar-Dhjetor 2025 ka qenë në total 54.675 mijë lekë dhe realizimi ne vleren 22.418 mije leke me nje diference prej 32.257 mije lek ose 41%. Ne krahasim me te njejten periudhe te vitit (21.851) kaluar jane arketuar 567 mije lek me shume.

Sa shihet pjesa me e madhe e mosrealizimit te tarifes se pastrimit, vjen nga kategoria popullsi e cila per periudhen 12 mujore eshte e realizuar vetem 22,071 mije leke, ose 67 % ndersa biznesi e ka ealizuar 73 % te planit vjetor.

Diferenca prej 16,903 mije lekesh perben 22 % te mosrealizimit te te ardhurave gjithsej.Kjo per faktin se nuk kemi arritur te bejme nje marveshje me Ndermarjen Ujesjelles Kanalizime Durres per faturimin e kesaj takse ne faturat e Ujit te pijshem.Vijon puna nga Drejtoria e Taksave Tarifave dhe Kadastres fiskale per arketimin e te ardhurave nga subjektet dhe popullsia.

Planifikimi i tarifës së shërbimit te ndricimit për periudhen Janar-Dhjetor 2025 ka qenë në total 2,643 mijë lekë dhe realizimi ne vleren 2,109 mije leke me nje diference pre 534 mije lek ose 80%. Ne krahasim me te njejten periudhe te vitit te kaluar jane arketuar 651 mije leke me shume.

Gjate periudhes Janar- Dhjetor 2025 shpenzimet ne total jane realizuar ne masen 66 % (realisht duke zbritur pjesen e rindertimit prej 189.602 mije lekesh , shpenzimet jane realizuar 682,157 ose 77 %) dhe te ndara sipa programeve.

Pra sic shihet nga te dhenat e kesaj tabele shpenzimet per paga dhe sigurime shoqerore jane realizuar ne masen 97 % , dhe ky mos realizim ka ardhur nga mos perodrimi i fondit vecante dhe mosplotesimi ne organike i te gjithe struktures se miratuar ne vendimin perkates.Shpenzimet operative ne total jane realizuar ne masen 77 % ,ndersa shpenzimet kapitale ne total jane realizuar 83 % dhe ne menyre te holllesishme do ti paraqesim meposhte ne analizen e shpenzimeve sipas programeve.

Programi 01110 " Organet ekzekutive dhe legjislative,Ceshtjet financiare " ne total eshte realizuar ne masen 95 % ose - 6,770 mije leke .

Ky program perfshin organizimin e Administratës së Bashkisë së Shijak në funksion të përmbushjes së misionit,qëllimeve, objektive dhe përgjegjësi të Bashkisë së Shijak për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Kemi synuar sigurimin e mbështetjes së funksionimit të Administatës së Bashkisë Shijak përmes realizimit në kohë të shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Mbështetje e

strukturës funksionale me 122 punonjës me kohe te plote me nje fond faktik 110,706 mije leke dhe realizuar 100 % .

Ne llogarine ekonomike me kodin 602 futen shpenzimet per mallra e materiale, dhe sherbime baze. Shërbim me kancelari dhe shtypshkrime për administratën e Bashkisë ka mundësuar sigurimi dhe furnizimi i vazhdueshëm me kancelari, letër, tonera te PC dhe fotokopjesh, shtypshkrime etj për te përmbushjen e detyrave administrative për të gjithë administratën.

Është realizuar funksionimi normal i të gjithë administratës së Bashkisë së Shijak nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse bazë si interneti, ujë, energji elektrike, ngrohje, komunikim postar etj.

Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e administratës së Bashkisë së Shijak . Është realizuar furnizimi sistematik me karburant i mjeteve të transportit për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme të administratës vendore të Bashkisë në qendër,njësi administrative etj,dhe ketu vetem mosrealizimi I zerit te sherbimeve te tjera eshte ne mase 84 % ose ne vlere 30,565 mije leke,keshtu aktualisht shpenzimet operative jane ne vleren 6,032mije leke parealizuara sic jane fatura te ndryshme apo kontrata te pa mbyllura te cilat jane planifikuar per pagese ne muajt ne vazhdim.

Shuma prej 1,200 lekesh e planifikuar per blerje kompjutera, printera.Aktualisht ne totalin e investimit ne kete program eshte ralizuar blerja e paisjeve elektronike (PC +Printera) ne shumen 800 mije leke, diferenca eshte kursim nga procedure prokurimit.

Sonila Sinjari (këshilltare):E kemi lexuar materialin Pranvera,ju falenderojmë,mendoj të kaloojmë në pikën tjetër.

Ardian Kokomani(këshilltar):Si trashëgohen të ardhurat,investimet kur rrugët janë në gjendje katastrofe.A mos vallë prisni të fillojë fushata ?Kur janë lekët dhe rruga është katastrofë nuk investohet është e pashpjegueshme ka një arsye pse.

Pranvera Alushi:Rugët nuk janë të mbyllura.

Ardian Kokomani(këshilltar):Tani futju rrugës nga Pjeza deri te komuna dhe shiko cfare ndodh,këputen makinat në mes.

Pranvera Alushi:Tani për konfirmin të gjithë gjësë,kemi një muaj dhe jo vetëm ne por e gjithë qeveria e dini të gjithë jemi bllokuar nuk punon sistemi për hedhjen e procedurave,dosjet për prokurime janë stif nëpër tavolina për tu hedhur vetëm në sistem.

Ardian Kokomani(këshilltar):U sqarova,dhe një dicka tjetër,tokat që janë fshatrat buzë lumit,të gjithë pagujanë taksa ata janë të gjitha të mbytura.Sa herë bie shi ata përmblyten,del lumi nga shtrati.Mund të përjashtohen nga taksa këta banorë ?Taksa e tokës flas,se janë hallxhinj kanë mbjellë grurë kanë harxhuar lekët e ju ka mbytur toka.A mund të merret një vendim?Jo dëmshpërblim.

Pranvera Alushi:Mund të bëjmë një propozim për ndryshim në Paketën Fiskale,për të diferencuar familjet që kanë tokat pranë bregut në lumit.

Sulejman Tola:Nësë nuk keni më diskutime kalojmë në pikën e katërt ,mbi materialin e pagave.Fjalën e ka përsëri znj.Pranvera.

Pranvera Alushi: Bazuar në Ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore",Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.776 date 19.12.2025 "Mbi përcaktimin e pages minimale në shkallë vendi", në VKM nr 87 date 06.02.2026 "Per disa ndryshime në vkm nr 326 date 31.05.2023 për pagat e punonjesve mbështetes dhe të tjere të speciliteteve të ndryshme të administrates publike"në VKM nr 103, datë 11.02.2026, "Per disa ndryshime në VKM nr 328 date 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve,grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore"

VKM nr 104 date 11.02.2026 "Per miratimin e vlera të secilit element perberes të pages bruto mujore të punonjesve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi ",

Duke u mbështetur në vkm-te e sipercituara dhe duke patur një numër banoresh prej 48,586, kategoria dhe paga për pozicion na përket sipas tabelës si më poshtë, miratuar në VKB nr 28 date 26.08.2024" Për ndryshimin e VKB nr 29 date 24.07.2023 mbi miratimin e pagave të punonjësve dhe personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në bashkinë Shijak për vitin 2024" paraqesim projekt vendimin për ndryshimin e niveli të pagave për pozicion sipas

VKM nr 776 date 19.12.2025 "Mbi përcaktimin e pages minimale në shkallë vendi", nën të detyrueshëm ndryshimin e pages minimale nga 40 mijë në 50 mijë leke , kështu të gjithë punonjësit që kanë qenë me atë page automatikisht kalojnë me kufirin e ri.

Për sa i përket pagave të tjera rritja është rezultat i indeksimit në masën 2.5% dhe i politikës së rritjes së pagave për punonjësit që i përkasin fushës së veprimit të vkm respektive.

Efektet financiare kanë qenë parashikuar në buxhetin bazë të vitit të kaluar,pasi dhe qeveria I pati dërguar fondet në fund të vitit 2025 dhe kështu në thjeshtë do të miratojmë pozicionin për secilën pagë duke paraqitur sa ishte dhe sa ndryshon pozicioni. Drejtorite në kopeshtet me dhe pa ushqim kanë paraqitur kërkesën për një punonjës në dispozicion me detyrën e edukatorës , për rastet e plotësimit të numrit të punonjesve arsimore në rastet e mungesave për arsye të ndryshme të punonjesve të përhershëm , për të patur një vijueshmëri normale të punës në këto institucione, propozojmë të miratoni shtimin e (1) një numri punonjës me detyrë edukatore, fondi i cili do të përballohet nga fondi ekzistues i pagave në programin e arsimit parashkollor.

Përt ë gjithë bashkinë do të jetë vërtëm një edukatore e cila do të ketë rolin e zëvendësueses nëse do të ketë mungesë të ndonjë edukatorje.Realisht janë mbuluar me numrin ekzistues,por e kanë parë si domosdoshmëri.

Sulejman Tola:Pyetje ?E kalojmë në votim ?



Kozeta Doda (Sekretare e Keshillit Bashkiak): Hapim procesin e votimit per piken e katërt të rendit të ditës.

Pro: 14

Kunder:-

Abstenim:-

Miratohet

Sulejman Tola: Vazhdojmë me shtesën e buxhetit.

Pranvera Alushi: Bashkia Shijak nga viti 2025 trashëgon shumën 514,185,897.94 leke ku ben pjese edhe granti I rindertimit I per shumën 351,758,515.70 leke, do te bene rezultatin e fund vitit ne pasqyrat financiare per vitin 2025 te Bashkise Shijak.

Ne tabelen ne materialin tuaj kemi te dhenat me shifrat e te ardhurave te trashëguara nga vitit 2025 te detajuara sipas zerave te llogarive ekonomike nga kane rezultuar keto teprica , ku perfshihen edhe te ardhurat e arketuara nga burime te ndryshme deri me daten 31.12.2025, ketu perfshihen llogaria me kodin 6999 per shumën 48,095,696.33 qe jane te ardhura te mbledhura gjate muajit dhjetor 2025 , si edhe grantet e celura deri me date 30.12.2025 I pa perfshire ne buxhetin baze.

Granti i Rindertimit trashëgohet per totalin e mesiperme I ndare ne grant rindertimi per shumën 165,397,067.70 leke per llogarine 6061041 , dhe shumame kodin e llogarise per investime per 24,207,009.00 leke eshte e perbere nga 2 objekte , sic eshte investimin me object "Riforcim njesive te banimit , pallate " per shumën 8,810,150.00 leke , dhe shuma 15,396,859.00 leke per investimin me object' Ndertimi I Pallatit te Kultures ,Shijak" Ndersa shuma 162,154,439 leke jane grante te celuara me date 30.12.2025 , kodet e te cilave ne I kemi miratuar me VKB nr 4 date 03.02.2026.

Ne zbatim te ligjeve dhe udhezimeve te mesiperme nga totali I te ardhurave per tu detajuar eshte shuma 161,361,198.82 leke, si gjendje nga programe te ndryshme te shpenzimeve dhe nga te ardhura te mbledhura ne dhjetor te viti 2025. Ne kete shume ben pjese edhe shuma 10,912,980.49 nga e cila ne kemi detajuar pjesen e grantit te performances per pjesen burim I brendshem per Shumën 4,943,820.22 leke te miratuar me VKB nr 5 date 03.02.2026 me object "Mbi perdorimin e fondit nga granti I performances per bashkite per vitin 2025" Sipas te dhenave aktualisht per te detajuar na ngelet shuma 156,417,378.60 leke.

Planifikimi I shpermdarjes se kesaj shume fillon me mbylljen e detyrimeve te kontraktuara ne vitin 2025, per fatura te pashlyera ,per vazhdimin e projekteve te nisura ,mos likujdimi I subjekteve per investimet apo pune te tjera ka ardhur nga mungesa e plote e dokumentacioneve nga ana e firmave sipermarrese. Diferenca e fondeve te ngelura pas detyrimeve te kontraktuara do te perdoren per kryerjen e puneve te reja sipas prioriteteve te dala nga grupi per menaxhim strategjik, te pa mbuluara nga buxheti baze.



Pune te reja kemi planifikuar per plotesimin e nevojave per paisje ne kopeshite e cerdhen e qytetit me blere lavatrice,tharrese rrobash,sobe gatimi,fshese korenti etj sipas kerkesave te paraqitura nga drejtuesit e ketyre institucioneve per shumen 1.000 mije leke.Blerje e paisjeve kompjuterike , printera per nevojate bashkise shijak ne shumen 1.200.mije leke, po keshtu kemi planifikuar shumen per mbikqyrje dhe kolaudime , te dhenat sipas tabelës qe keni ne material.

Sic shihet nga tabela kemi per shpenzimet operative shumen 23,189,722.83 leke per sherbime te palikujduara nga vitit I kaluar vetem sherbimi I pastrimit ze 20 milione leke per mungese te paraqitjes se dokumentacionit ne afat, te tjera jane fatura te palikujduara per blerje te ndryshme.ndersa diferenca 10,827,655.77 jane shpenzime te reja operative.

Ndersa per sa I perket shtesave ne investime kemi Shumen 40,900,000.00 per investime te vitit 2025 te planifikuara por te pa realizuara realisht, dhe kemi fondin 81,500,000.00 leke per investime te reja.Konkretisht kemi shtese ne objektin "Riparim i shtresave asfaltike rruga Gani Keta,"per degezimin e kesaj rruge qe e lidh me sheshin e tre pallateve ,Kemi shtese ne objektin "Riparim i shtresave asfaltike rruga Hardhishtë- Gjepalaj"ne Nj Ad Gjepalaj per degezimet e disa rrugeve te paperfshira ne projektin fillestar,kemi shtese ne projektin e "Sistemim , asfaltim I rrugëve ne : lagja e "Re Bodinok" & lagja e Re Metallaj. Nj.Ad. Maminas" duke e mbyllur keshtu gjithë gjatesine e kesaj rruge.

Domosdoshmeri kemi plotesimin e kushteve per zhvillimin normal te punes per administraten e bashkise Shijak ku aktualisht nje pjese emire eshte e akomoduar ne ambiente me qera, eshte planifikuar arredimi dhe pershtatja e dy ambienteve ne katet e para te pallateve te rindertimit perzyra te administrates, nga eshte planifikuar shume per 10 milion lekesh.

Investim I ri mbetet edhe shuma prej 8 milion lekesh per rehabilitim te rrugeve te brendshme te pa perfshira ne te gjitha Nj.Ad te bashkise Shijak.

Sipas te dhenave per shtesen e buxhetit zerat e shpenzimeve operative zene 22% ,ndersa investimet zene 78 % te shteses se buxhetit . (pa perfshire rindertimin)

Buxheti i Bashkise rritet ne total me 16.4 % ose ne vlere 1,149,454,254.24 leke (pa fondet e rindertimit) dhe vetem investimet shkojne ne shumen 488,686,820.22 leke duke zene keshtu 42.4 % te buxhetit , pagat dhe sig shoqerore 36% ,dhe shpenzimet operative dhe transfertat 21.6% te totalit te buxhetit.

Buxheti perfundimtar I Bashkise Shijak per vitin 2026 se bashku me grantet e rindertimit te trasheguara nga viti 2025 shkon ne 1,501,212,769.94 leke.

Faleminderit !

Elson Kastrati (këshilltar):Në material paraqiten dy shuma të ndryshme,fondi i trashëguar 514 milion dhe fondi tjetër 509 milion.Kush është nga këto të dyja ?

Pranvera Alushi:Fondi 514 milion është e gjithë shuma që jua citova granti i performancës,është diferencë që e kemi miratuar.Qeveria na e ndau një pjesë fond performace nga dy burime i brëndshëm dhe i huaj.Të brëndshmin duhet ta fus tek të mijat tek të ardhurat që ne

trashëgojmë, kurse burimi i huaj nuk është akoma disponibël pasi unë kam cuar vendimin që morëm në datë 3 shkurt që ata të na alokojnë fondet.

Suleman Tola: E hedhim në votim.

Kozeta Doda (Sekretare e Këshillit Bashkiak): Hapim procesin e votimit për piken e pestë të rendit të ditës.

Pro: 14

Kunder: -

Abstenim: -

Miratohet


Sulejman Tola: E fundit, ky material është vetëm për vënie në dijeni të Këshillit, relaton Znj. Sonila Guzina.

Sonila Guzina: Ky relacion paraqitet për vënie në dijeni të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Shijak, lidhur me procedurën institucionale të ndërmarrë nga Bashkia Shijak dhe Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Shijak për hapjen e klasave në gjuhën boshnjake në shkollën 9-vjeçare "Adem Sabli", Borakë.

Nisma është ndërmarrë në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi që garanton të drejtën e pakicave kombëtare për arsimim në gjuhën amtare, si dhe si përgjigje ndaj kërkesave të dokumentuara të komunitetit boshnjak dhe prindërve të nxënësve që ndjekin arsimin parauniversitar në këtë institucion.

Në këtë kuadër, Bashkia Shijak, në bashkëpunim me Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Shijak, ka hartuar dhe do të përcjellë pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit propozimin zyrtar për hapjen e klasave në gjuhën boshnjake, të shoqëruar me studimin argumentues përkatës mbi domosdoshmërinë, përqendrimin e nxënësve dhe plotësimin e kushteve infrastrukturore dhe organizative.

Procedura është zhvilluar në përputhje me kompetencat ligjore të pushtetit vendor dhe strukturave arsimore vendore dhe nuk kërkon vendimmarrje apo votim nga Këshilli Bashkiak, duke qenë se miratimi përfundimtar i hapjes së klasave në gjuhën e pakicave kombëtare i takon autoritetit përgjegjës qendror.



Përmes këtij relacioni, Këshilli Bashkiak informohet mbi ecurinë e kësaj procedure, e cila synon garantimin e të drejtave arsimore të pakicës kombëtare boshnjake, ruajtjen e identitetit gjuhësor dhe kulturor të komunitetit, si dhe forcimin e parimeve të gjithëpërfshirjes dhe respektimit të diversitetit në nivel vendor.

Faleminderit te gjithëve per pjesemarrjen!


MBAJTESI I PROTOKOLLIT

Kozeta Doda



KRYETARI I KESHILLIT

Sulejman Tola



Maribeta Tuder



Lumturije Keçi



Yola Sufija

